



## Udhëzimi 10

Shtator 2016

### Prokurimi publik

# Procedurat e prokurimit publik

#### PËRMBAJTJA

- [Hyrje](#)
- [Llojet kryesore të procedurave konkurruese në dispozicion](#)
- [Kur mund të përdoret secila prej procedurave kryesore konkurruese?](#)
- [Procedura e partneritet të inovacionit](#)
- [Procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

## Hyrje

Supozimi themelor në prokurimin publik është se kontratat e një lloji dhe vlere të caktuar do të prokurohen duke përdorur një procedurë të shpallur, konkurruese që është e hapur, e drejtë dhe transparente, duke siguruar mundësi dhe trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit. Vetëm rrethanat e kufizuara lejojnë përdorimin e një procedure pa konkurrim të shpallur.

Procedurat kryesore konkurruese të prokurimit që janë në dispozicion në bazë të Direktivës së Sektorit Publik (Direktiva)<sup>1</sup> janë procedura e hapur, procedura e kufizuar, procedura e dialogut konkurrues, procedura konkurruese me negociim, dhe procedura e partneritetit të inovacionit.

Procedura e hapur dhe procedura e kufizuar janë procedurat e preferuara, pasi ata mund të përdoren pa plotësuar të gjitha kushtet. Procedura e dialogut konkurrues, procedura konkurruese me negociim, dhe procedura e partneritetit të inovacionit mund të përdoren vetëm kur janë plotësuar kushtet e caktuara. Në Direktivë është vendosur edhe një procedurë e veçantë, që është konkursi i projektimit.

Direktiva përcakton proceset që duhet të ndiqen nga një autoritet kontraktor kur përdor secilën nga procedurat e mësipërme konkurruese. Niveli i detajeve të përcaktuara në Direktivë ndryshon në varësi të procedurës.

Direktiva gjithashtu përfshin dispozita që mbulojnë mjetet e prokurimit që autoriteti kontraktor mund të zgjedhë për të përdorur në lidhje me procedurat konkurruese, aty ku lejohet. Këto mjete janë marrëveshja kuadër, ankandet elektronike, sistemet dinamike të blerjes dhe katalogët elektronik.

Nëse autoriteti kontraktor dëshiron të japë një kontratë pa konkurrim duke përdorur atë që është e njohur si "procedurës me negociim pa njoftim paraprak", ai duhet të plotësojë kushtet e veçanta të përcaktuara në Direktivë. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJED) ka vendosur që këto kushte janë interpretuar shumë të ngushtë dhe se dhënia e një kontrate pa konkurrim duhet të ndodhë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

## Llojet kryesore të procedurave konkurruese në dispozicion

Autoritetet kontraktore kanë në dispozicion pesë lloje kryesore procedurash:

- Procedura e hapur
- Procedura e kufizuar
- Procedura e dialogut konkurrues
- Procedura konkurruese me negociim
- Procedura e partneritetit të inovacionit.

**Procedura e hapur:** Procedura e hapur është një proces me një fazë. Autoriteti kontraktor shpall mundësinë e kontratës dhe pastaj nxjerr dokumentet e plota të ofertës, duke përfshirë specifikimet e kontratës, për të gjithë operatorët ekonomikë që kërkojnë të marrin pjesë. Të gjitha dokumentet e prokurimit duhet të jenë të disponueshme në mënyrë elektronike, pa pagesë, në datën e publikimit të njoftimit të kontratës. Të gjitha dokumentet e prokurimit duhet të jenë të plota dhe gjithëpërfshirëse në mënyrë që operatorët ekonomikë nuk do të kenë më nevojë që të kërkojnë dokumentacion; ata thjesht do të shkarkojnë të gjitha dokumentet përkatëse.

Operatorët ekonomikë dorëzojnë si informacionet e përzgjedhjes (kualifikimit) ashtu dhe ofertat në të njëjtën kohë në përgjigje të kërkesave të shpallura të autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor

<sup>1</sup> Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

mund të marrë një numër të madh ofertash; ai nuk mund të përcaktojë paraprakisht numrin e ofertave që do të marrë, por jo të gjitha këto oferta domosdoshmërisht do të merren parasysh.

Shqyrtohet vetëm ofertat nga operatorët ekonomik të kualifikuar që kanë dorëzuar dokumentet e kërkuara dhe që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes. Ofertat vlerësohen mbi bazën e ofertës ekonomike më të favorshme.

Nuk ka negociata lejohe me operatorët ekonomik, edhe pse autoritetet kontraktore mund të qartësojnë aspektet e ofertës me ofertuesit.

**Procedura e kufizuar:** Procedura e kufizuar është një proces me dy faza. Autoriteti kontraktor reklamon mundësi kontratë, dhe operatorët ekonomikë dorëzojnë kërkesat për të marrë pjesë dhe pastaj japin informacionin e fazës së zgjedhjes (para-kualifikimit), i cili përdoret nga autoriteti kontraktor për të vendosur nëse operatorët ekonomikë janë të kualifikuar apo jo për të kryer kontratën. Autoriteti kontraktor pastaj përzgjedh operatorët ekonomik që duhet të ftohen për tenderim.

Autoritetit kontraktor i lejohe që të kufizojë numrin e operatorëve ekonomikë që fton për tender dhe të hartojë një listë të shkurtër të operatorëve ekonomikë, që do të thotë se jo të gjithë operatorët ekonomikë që kualifikohen domosdoshmërisht do të ftohen për tenderim.

Autoriteti kontraktor e nxjerr ftesën për ofertë të plotë, së bashku me specifikimet e kontratës, për operatorët ekonomikë që ka përzgjedhur apo të përzgjedhur. Ndryshe nga procedura e hapur, procedura e kufizuar e lejon në këtë mënyrë autoritetin kontraktor që të kufizojë numrin e ofertave që ai merr.

Ofertat vlerësohen mbi bazën e ofertës ekonomike më të favorshme.

Nuk lejohen negociata me operatorët ekonomik, edhe pse autoritetet kontraktore mund të qartësojnë aspekte të ofertës me ofertuesit.

**Procedura e dialogut konkurrues:** Procedura e dialogut konkurrues është një proces me dy faza. Autoriteti kontraktor shpall mundësinë e kontratës, dhe pas dorëzimit të kërkesave për pjesëmarrje, operatorët ekonomikë paraqesin së pari informacionin e fazës së para-kualifikimit dhe përzgjedhjes, i cili përdoret nga autoriteti kontraktor për të vendosur nëse operatorët ekonomikë janë të kualifikuar apo jo për të realizuar kontratën dhe për të zgjedhur operatorët ekonomik që duhet të ftohen për ofertim.

Autoritetit kontraktor i lejohe të kufizojë numrin e operatorëve ekonomikë që fton për ofertë dhe të hartojë një listë të shkurtër të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti kontraktor nxjerr ftesën për të marrë pjesë vetëm për operatorët ekonomik që ka përzgjedhur, dhe pastaj hyn në një fazën e dialogut konkurrues me ata operatorë ekonomik.

Të gjitha aspektet e projektit mund të diskutohet me operatorët ekonomik gjatë fazës së dialogut konkurrues, dhe numri i zgjidhjeve mund të reduktohet si pjesë e procesit. Pasi autoriteti kontraktor bindet se ai do të marrë propozime që do të plotësojnë kërkesat e tij, ai e deklaron fazën e dialogut konkurrues të mbyllur dhe fton operatorët ekonomik që të paraqesin ofertat e tyre.

Ofertat mund të vlerësohen vetëm në bazë të raportit më të mirë çmim/cilësi.

Autoritetit kontraktor i lejohe që të negociojë me ofertuesin që paraqet raportin më të mirë çmim/cilësi, por vetëm për të konfirmuar angazhimet financiare ose kushtet e tjera të ofertës, që janë subjekt i garancive mbrojtëse.

**Procedura konkurruese me negociim:** Procedura konkurruese me negociim është një proces me dy faza. Autoriteti kontraktor shpall mundësinë e kontratës dhe operatorët ekonomikë paraqesin së pari informacionin e fazës së para-kualifikimit dhe të përzgjedhjes, i cili përdoret nga autoriteti

kontraktor për të vendosur nëse operatorët ekonomikë janë të kualifikuar apo jo për të realizuar kontratën. Më pas autoriteti kontraktor zgjedh operatorët ekonomik që duhet të ftohen për ofertim.

Autoritetit kontraktor i lejohe të kufizojë numrin e operatorëve ekonomikë që ai fton për ofertë dhe të hartojë një listë të shkurtër të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti kontraktor nxjerr ftesën për të negociuar vetëm me operatorët ekonomik që ka përzgjedhur. Ai merr propozimet fillestare dhe më pas hyn në negociata me ofertuesit e përzgjedhur në lidhje me këto propozime.

Ofertat vlerësohen mbi bazën e ofertës ekonomike më të favorshme.

**Procedura e partneritetit të inovacionit:** Procedura e partneritetit të inovacionit është një procedurë e re e prezantuar nga reformat e prokurimit të vitit 2014. Është një proces me dy faza dhe bazohet kryesisht në rregullat procedurale që zbatohen në procedurën konkurruese me negociim.

Autoriteti kontraktor shpall mundësinë e kontratës. Operatorët ekonomikë dorëzojnë informacionin, i cili përdoret nga autoriteti kontraktor për të përcaktuar nëse operatorët ekonomikë janë apo jo të përshtatshëm, nga pikëpamja cilësore, për të marrë pjesë në procesin e partneritetit inovacionit.

Autoritetit kontraktor i lejohe të kufizojë numrin e operatorëve ekonomikë që ai fton për ofertë dhe të hartojë një listë të shkurtër të operatorëve ekonomikë, ose të ftojë vetëm një operator ekonomik për të marrë pjesë në partneritetin e inovacionit.


Rregullat mbi zhvillimin e fazës së negociimit të procedurës së partneritetit të inovacionit janë fleksibël, dhe, për këtë arsye, mënyra në të cilën procedura zhvillohet mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme. Një parim themelor është se procedura kryhet në faza të njëpasnjëshme, të cilat duhet të jenë të strukturuar sipas sekuencës së hapave në procesin e kërkimit dhe inovacionit, të cilët mund të përfshijnë prodhimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve ose përfundimin e punimeve.

Të gjitha aspektet e projektit mund të diskutohen me operatorët ekonomik dhe numri i zgjidhjeve mund të reduktohet si pjesë e procesit gjatë partneritetit të inovacionit.

Autoriteti kontraktor ka mundësinë e blerjes së produkteve përfundimtare, shërbimeve ose punëve që janë zhvilluar përmes partneritetit të inovacionit, por nuk është i detyruar ta bëjë këtë.

Sipas kësaj procedure, kontrata mund të jepet vetëm në bazë të raportit më të mirë çmim/cilësi.

Diagrama 1. Procedurat kryesore konkurruese (duke përfshirur procedurën e partneritetit të inovacionit)



**Procedura e konkursit të projektimit:** Kjo procedurë konkurruese përfshin përdorimin e një jurie për të gjykuar projektimet e paraqitura. Rezultati i procedurës mund të jetë dhënia e kontratës së projektimit, i çmimit ose i të dyjave. Nuk ka kërkesa të detajuara në lidhje me numrin e fazave apo me procesin që do të përdoren. Megjithatë, ka rregulla në lidhje me mënyrën në të cilën juria konstituohet dhe vepron. Kjo procedurë mund të përdoret vetëm për projektimin e punëve publike dhe përdoret zakonisht në fushën e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës dhe inxhinierisë, ose përpunimin e të dhënave. Konkursi i projektimit që përdoret për përgatitjen e planeve të një projektimi të tillë financiar mund të përcaktojë gjithashtu se kontratat e mëvonshme të shërbimit për realizimin e projektimit inxhinierik do t'i jepen fituesit apo njërit prej fituesve të konkursit të projektimit me anë të procedurës me negociim pa shpallje paraprake.

### **Kur mund të përdoret secila prej procedurave kryesore konkurruese?**

**Procedurat e hapura dhe të kufizuara:** Autoriteti kontraktor është i lirë të zgjedhë ndërmjet procedurës së hapur dhe procedurës së kufizuar. Nuk aplikohen kushte ligjore në rrethanat në të cilat mund të përdoret çdonjëra nga këto dy procedura, dhe autoritetit kontraktor nuk i kërkohet që të përdorë një procedurë si preferencë ndaj një tjetre dhe për këtë arsye ka liri të plotë për të zgjedhur.

#### **E hapur apo e kufizuar? Zgjedhja se cilat procedura të përdoren**

Si pjesë e procesit të planifikimit të prokurimit, autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë me kujdes se cila prej procedurave është më e përshtatshme për prokurimin e veçantë. Në shumicën e rasteve kjo do të jetë një zgjedhje në mes të procedurës së hapur dhe procedurës së kufizuar.

Për prokurimin që është shumë kompleks, autoriteti kontraktor mund të ketë nevojë të marrë në konsideratë nëse ai mund të përdorë apo jo procedurën e dialogut konkurrues ose procedurën konkurruese me negociim. Për prokurime të specializuara mund të jenë të përshtatshme procedurat e tjera të përshkruara në këtë seksion.

**Avantazhet e procedurës së hapur:** Procedura e hapur parashikon masën maksimale të konkurrencës. Kjo është edhe procedura më transparente, pasi autoriteti kontraktor nuk ka liri në zgjedhjen e ndonjë ofruesi. Potenciali për korrupsion, ku favorizohet, për shembull një operator i veçantë ekonomik, është më e ulët. Në përgjithësi, marrëveshjet e fshehta mes operatorëve ekonomik kanë më pak të ngjarë të realizohen këtu.

Afatet ligjore janë edhe më të shkurtra në procedurën e hapur se sa në procedurën e kufizuar.

**Disavantazhet e procedurës së hapur:** Kostot e përgjithshme të autoritetit kontraktor kur përdor procedurën e hapur mund të jenë të larta, pasi ai duhet të nxjerrë dokumente të plota e ofertës për të gjitha palët (edhe pse këto kosto mund të reduktohen në mënyrë të konsiderueshme nëse dokumentet janë të disponueshme në mënyrë elektronike). Autoritetit kontraktor mund t'i duhet që të vlerësojë shumë aplikime në qoftë se janë të interesuar një numër i madh operatorësh ekonomik, dhe këto vlerësime mund të jenë të kushtueshme dhe mund të kërkojnë kohë. Përveç kësaj, operatorët ekonomik mund të jenë më pak të prirur për të marrë pjesë në një procedurë të hapur, nëse kontrata është më komplekse, dhe, si rezultat, dokumentet e ofertës nuk mund të përgatiten në mënyrë rutinore, pasi ato kërkojnë një nivel të lartë të dhënash. Kostoja e përgatitjes së një oferte të plotë mund të jetë një dekurajim për pjesëmarrje, ku gjasa për sukses është më e ulët për shkak të nivelit të lartë të konkurrencës.

**Avantazhet e procedurës së kufizuar:** Kufizimi i numrit të operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në fazën e tenderit mund të çojë në kosto më të ulëta dhe në më pak harxhim kohe vlerësimi për autoritetin kontraktor se sa në procedurën e hapur. Kufizimi i numrit të ofertuesve mund të ndihmojë në shmangien e kostove të panevojshme që lidhen me operatorët ekonomikë të papërshtatshëm. Ky kufizim mund të rezultojë në më shumë operatorë të interesuar ekonomik që

dorëzojnë oferta të cilësisë më të mirë, duke mundësuar konkurrencë më efikase.

**Disavantazhet e procedurës së kufizuar:** Potenciali për korrupsion në këtë procedurë është më i madh për shkak të përdorimit të rritur të diskrecionit nga autoriteti kontraktor, dhe mundësia e marrëveshjeve të fshehta mund të jetë më e lartë. Afatet ligjore janë edhe më të gjata në procedurën e kufizuar se sa në procedurën e hapur.

## Praktika e mirë

Procedura e hapur është në përgjithësi e përshtatshme për blerjet e drejtpërdrejta rutinë dhe të tipit të mallrave.

Procedura e kufizuar mund të përdoret për blerjet e drejtpërdrejta rutinë dhe të tipit të mallrave kur autoriteti kontraktor është i mendimit se përfitimet do të rrjedhin nga kufizimi i numrit të ofertuesve. Procedura e kufizuar është veçanërisht e përshtatshme për prokurimin më kompleks dhe për blerjen jo-rutinë.

Kur përcaktohet se cilat procedurë të përdoret, autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë një sërë faktorësh, duke përfshirë kostot për organizimin e procedurës, përfitimet e konkurrencës së plotë dhe të hapur, avantazhet e kufizimit të konkurrencës, dhe rrezikun e mundshëm të korrupsionit dhe/ose të marrëveshjes së fshehtë.

**Procedura e dialogut konkurrues dhe procedura konkurruese me negociim:** Procedura e dialogut konkurrues dhe procedura konkurruese me negociim mund të përdoren vetëm kur plotësohen kushtet specifike. Direktiva nuk ka dispozita ligjore që kërkojnë që autoriteti kontraktor të përdorë një nga këto procedura si preferencë ndaj një procedure tjetër, dhe të njëjtat kushte vlejnjë për të dyja procedurat.

Rethanat dhe kushtet, të cilat janë njësoj të zbatueshme për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Në përgjigje të një procedure të hapur ose të kufizuar janë marrë vetëm oferta të parregullta dhe të papranueshme.

**Ofertat e parregullta:** Direktiva përcakton se "ofertat që nuk janë në përputhje me dokumentet e prokurimit, që janë pranuar me vonesë, ku ka prova të marrëveshjeve të fshehta ose të korrupsionit, ose që janë gjetur nga autoriteti kontraktor si anomalisht të ulëta, konsiderohen si të parregullta". Kjo listë nuk është shteruese.

**Ofertat e papranueshme:** Direktiva përcakton se "ofertat e paraqitura nga ofertuesit që nuk kanë kualifikimet e kërkuara, dhe ofertat, çmimet e të cilave tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor të përcaktuar dhe të dokumentuar para nisjes së procedurës së prokurimit konsiderohen si të papranueshme." Kjo listë nuk është shteruese.

Në rastin e ofertave të parregullta dhe të papranueshme, autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të shpallë një tjetër Njoftim të Kontratës, me kusht që ai përfshin në procedurë "të gjithë, dhe vetëm, ofertuesit të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret [për përzgjedhjen cilësore] dhe të cilët, gjatë procedurës paraprake të hapur ose të kufizuar, kanë dorëzuar oferta, në përputhje me kërkesat formale të procedurës së prokurimit". Në këtë rast, operatorët e rinj ekonomik nuk ftohen të marrin pjesë në procesin e mëvonshëm, dhe nuk ka as një fazë të shprehjes së interesit dhe as një fazë të përzgjedhjes.

### Shembull

Autoriteti kontraktor i sektorit të shëndetësisë nis një procedurë të kufizuar të prokurimit për një kontratë për të siguruar një pajisje me rreze x. Janë paraqitur dhe vlerësuar katër oferta, por të katër ofertat përfshijnë ndryshime të vogla të specifikimeve teknike, ku asnjëri prej tyre nuk lejohet.

Autoriteti kontraktor vendos që të fillojë një procedurë konkurruese me negociim, duke i ftuar katër operatorët ekonomik që kanë dorëzuar ofertat fillestare që të marrin pjesë në negociatë. Autoriteti kontraktor negocion me të gjithë ofertuesit ofertat që ata kanë paraqitur fillimisht. Qëllimi i negociatave është që të përshtaten ofertat e paraqitura me kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në njoftimin e kontratës, në specifikimet dhe dokumentet shtesë për të marrë oferta të rregullta dhe të pranueshme.

- Nevojat e autoritetit kontraktor nuk mund të plotësohen pa përshtatjen e zgjidhjeve të gatshme që janë në dispozicion.
- Punët, furnizimet apo shërbimet që do të prokurohen përfshijnë projektim apo zgjidhje inovative.
- Specifikimet teknike nuk mund të përcaktohen me saktësi të mjaftueshme nga ana e autoritetit kontraktor me lidhje me standardet e përcaktuara, specifikimet e zakonshme teknike ose referencat teknike.

Në rastin e kontratave të punëve, situatat e mbuluara nga një ose me shumë prej tre pikave të mësipërme të theksuara mund të përfshijnë punë të cilat mund të mos jenë ndërtime standarde ose punët përfshijnë projektim apo zgjidhje inovative. Në rastin e shërbimeve ose të furnizimeve, situata përkatëse do të jenë ato që kërkojnë përpjekje të përshtatjes apo të projektimit, të cilat janë veçanërisht të nevojshme në rastin e blerjeve të ndërlikuara që përfshijnë produkte të sofistikuara ose shërbime intelektuale, të tilla si shërbimet e konsulencës, shërbimet arkitektonike, shërbimet inxhinerike, apo projekte të mëdha të teknologjisë së informacion dhe të komunikimit (TIK). Në këto raste, negociatat mund të jenë të nevojshme për të garantuar që furnizimet apo shërbimet në fjalë korrespondojnë me nevojat e autoritetit kontraktor. Në lidhje me shërbimet apo furnizimet e gatshme që mund të ofrohen nga operatorët e ndryshëm në treg, nuk duhet të përdoret procedura konkurruese me negociim ose procedura e dialogut konkurrues.

### Shembull

Një autoritet lokal dëshiron të japë një kontratë për ndërtimin e një ndërtese të re për zyra në qendër të një qyteti, ku dihet se ka të ngjarë që të gjenden mbetje arkeologjike, të cilat do të duhet të mbrohen gjatë procesit të ndërtimit. Autoritetet lokale nuk e dinë se sa risk janë të gatshëm që të marrin operatorët ekonomikë në lidhje me ndikimin e mbrojtjes së mbetjeve arkeologjike në koston dhe kohën e ndërtimit. Kjo çështje do të kërkojë negociatë me operatorët ekonomikë

### Praktikë e mirë

Duhet të caktohet një udhëheqës projekti për të siguruar bashkëpunimin ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit

- Kontrata nuk mund të jepet pa negociatë paraprake për shkak të rrethanave të veçanta që lidhen me natyrën, kompleksitetin, organizmin apo ligjor dhe financiar, ose për shkak të rreziqeve që i bashkëngjiten këtyre rrethanave.



## Procedura e partneritetit të inovacionit

Procedura e partneritetit të inovacionit është një procedurë e re e krijuar nga Direktiva. Ajo mund të përdoret në mënyrë të veçantë kur nevojat nuk mund të plotësohen duke blerë produkte, shërbime apo punë që janë tashmë të disponueshme në treg dhe, rrjedhimisht, kërkohet një zgjidhje që përfshin inovacion.

Partneriteti i inovacionit është një procedurë që synon në mënyrë të qartë zhvillimin e, shërbimeve apo punëve produkteve të reja dhe blerjen e mëvonshme të këtyre furnizimeve, shërbimeve ose punëve.

Përkufizimi i "**inovacionit**" i referohet "zbatimit të një produkti, shërbim apo procesi të ri ose të përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, duke përfshirë, por jo vetëm, procesin e prodhimit, proceset e ndërtimit apo të konstruksionit, një metodë të re të marketingut, ose një metodë të re organizative të praktikave të biznesit, organizimi në vendin e punës ose marrëdhëniet e jashtme me qëllim, *ndër të tjera*, për të ndihmuar në zgjidhjen e sfidave shoqërore, ose për të mbështetur Strategjinë Evropë 2020 për rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse"<sup>2</sup>.

Në të gjitha situatat, partneriteti i inovacionit duhet të strukturohet në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë "tërheqjen" e nevojshme "të tregut", motivimin e zhvillimit të një zgjidhje inovative, pa përjashtuar tregun.

## Rregullat e zhvillimit të procedurave konkurruese

Direktiva përmban rregulla të detajuara për kryerjen e procedurave konkurruese që mbulojnë çështje të tilla si shpallja, procesi i përzgjedhjes dhe kriteret që do të përdoren, përmbajtja e dokumenteve të ofertës, kriteret e vlerësimit të ofertës, si dhe afatet kohore ligjore që zbatohen për secilin nga proceset.

**Afatet ligjore:** Afatet kohore kryesore ligjore kanë të bëjnë me sa më poshtë:

- Kohën në mes të publikimit të Njoftimit të Kontratës në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE)* dhe datës së mbylljes për marrjet e kërkesave për pjesëmarrje;
- Kohën në mes të dërgimit të ftesës për ofertë dhe kthimit të ofertave;
- Periudhën e ankesave pas vendimit për shpalljen e kontratës fituese.

Afatet kohore ligjore zbatohen edhe për sigurimin e informacionit për operatorët ekonomikë në rrethana të veçanta.


Shembuj se si afatet kohore ligjore ndikojnë në një proces prokurimi janë dhënë në skemën e mëposhtme, e cila është e bazuar në procesin e tenderimit me procedurë të kufizuar.

Në rrethana të caktuara, të tilla si situatat e jashtëzakonshme dhe situatat ku Njoftimi Paraparak i Informacionit është publikuar apo kur autoriteti kontraktor është autoritet nën-qendror, është e mundur që të reduktohen afatet kohore ligjore. Një reduktim i tillë është subjekt i përmbushjes së disa kushteve, të cilat janë të përcaktuara në Direktivë. Këto rrethana nuk janë të përfshira në skemën më poshtë.

---

<sup>2</sup> [EVROPA 2020. Strategjia evropiane për rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse](#)

## Procedura e kufizuar – afatet kryesore ligjore



### Shërbimet

**Zgjedhja e shpalljes:** Shërbimet kanë zgjedhje të lirë në mes të pesë formave kryesore të procedurës konkurruese: procedurës së hapur, procedurës së kufizuar, procedurës së dialogut konkurrues, procedurës me negociim me ftesë paraprake për konkurrim, dhe procedurës së partneritetit të inovacionit. Shërbimet në përgjithësi kanë më shumë fleksibilitet në drejtim të asaj se si ato bëjnë shpallje.

**Kryerja e procesit të prokurimit:** Dispozitat e Direktivës së Shërbimeve që mbulojnë zhvillimin e procesit të prokurimit në përgjithësi janë më pak të detajuara dhe më pak përshkruese se rregullat që zbatohen në sektorin publik. Për shembull, nuk ka listë të gjerë të kriterëve të fazës së përzgjedhjes, dhe ka dispozita që lejojnë afate kohore për pranimin e ofertave që do të vendosen me marrëveshje të ndërsjellë.

### Procedura me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës

Autoritetet kontraktore duhet të fillojnë me supozimin se kërkohet proces konkurrues me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në *GZBE*. Vetëm në rrethana shumë të kufizuara - ku një kontratë është e një lloji dhe vlere të veçantë dhe është subjekt i dispozitave të plota të Direktivës – mundet që një kontratë të jepet pa shpalljen paraprake të njoftimit të kontratës dhe pa përdorimin e një procesi konkurrues.

**Kujdes!** Praktika gjyqësore e GJED-së e bën të qartë se disponueshmëria e përjashtimeve nga kërkesat për shpallje duke përdorur Njoftimin e Kontratës në *GZBE* dhe duke organizuar një proces konkurrues është interpretuar shumë ngushtë. Barra i takon autoritetit kontraktor që të demonstrojë përputhshmërinë me kushtet që justifikojnë një metodë të tillë.

**Cilat janë përjashtimet nga detyrimi për të publikuar një Njoftim të Kontratës dhe për të përdorur një proces konkurrues?** Përjashtimet ndryshojnë sipas llojit të kontratës dhe rrethanave. Në mënyrë të përmblodhur:

## Përrjashtimet për kontratat e punëve publike, të furnizimeve publike dhe të shërbimeve publike:

- **Nuk janë marrë oferta/kërkesa për pjesëmarrje ose nuk janë marrë oferta/kërkesa të përshtatshme për pjesëmarrje**, në përgjigje të një procedure të hapur ose të një procedure të kufizuar, me kusht që kushtet e kontratës nuk janë ndryshuar në thelb.
  - **Oferta që nuk është "e përshtatshme"**: Direktiva parashikon se "një ofertë konsiderohet e përshtatshme kur ajo është e parëndësishme për kontratën, duke qenë haptazi e paaftë që, pa ndryshime thelbësore, nuk mund të përmbushë nevojat e autoritetit kontraktor dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet e prokurimit".
  - **Kërkesa për të marrë pjesë që nuk është "e përshtatshme"**: Direktiva parashikon se "një kërkesë për pjesëmarrje konsiderohet e përshtatshme, kur operatori ekonomik në fjalë duhet ose mund të përjashtohet në bazë të [shkaqeve të përjashtimit] ose nuk plotëson kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti kontraktor".
  - **Kujdes!** Vini re dallimin në mes të konceptit të ofertave ose të kërkesave për pjesëmarrje "të papërshtatshme", si në këtë rast, dhe konceptit të ofertave "të parregullta" dhe "të papranueshme", të cilat lejojnë përdorimin e procedurës së dialogut konkurrues dhe të procedurës konkurruese me negociim.
- **Arsye artistike ose teknike për mbrojtjen e të drejtave ekskluzive**: Kur "qëllimi i prokurimit është krijimi apo marrja e një pune të veçantë arti apo të performancës artistike", ku konkurrenca mungon për arsye teknike ose për arsye që lidhen me "mbrojtjen e të drejtave ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale", kontrata mund t'i jepet vetëm një operatori të caktuar ekonomik.
  - Përrjashtimet për arsye teknike për mbrojtjen e të drejtave ekskluzive zbatohen vetëm kur:
    - Nuk ekziston alternativë apo zëvendësim i arsyeshëm;
    - Mungesa e konkurrencës nuk është rezultat i një ngushtimi artificial të parametrave të prokurimit.
- **Urgjencë ekstreme**: Për shkak të "ngjarjeve të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor", afatet kohore në dispozicion për procedurën e hapur ose të kufizuar nuk mund të përmbushen. Këto shkaqe duhet të përdoren vetëm aty ku është "e domosdoshme" për ta bërë këtë.
  - Rrethanat e krijuara për të justifikuar urgjencën ekstreme "nuk duhet në asnjë rast t'i atribuohen autoritetit kontraktor". Planifikimi i dobët nuk mund të pranohet si arsye për aplikimin e procedurës me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës.

## Përrjashtimet për kontratat e furnizimeve publike:

- **Produktet e prodhuara vetëm për qëllime të kërkimit dhe zhvillimit**: Produktet e përfshira prodhohen vetëm për qëllime kërkimore, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. Këto arsye nuk zbatohen kur ekziston sasi prodhimi që krijon qëndrueshmërinë tregtare apo që rikuperon kostot e kërkimit dhe zhvillimit.
- **Furnizime shtesë nga një furnizues original**: Shmangia vlen për "furnizime shtesë nga furnizuesit fillestar të cilët kanë për qëllim ose zëvendësimin e pjesës së furnizimeve ose instalimeve ose zgjerimin e furnizimeve ose instalimeve ekzistuese", ku:
  - "ndryshimi i furnizuesit do ta detyronte autoritetin kontraktor që të mernte material që ka karakteristika të ndryshme teknike të cilat do të rezultojnë në papajtueshmëri ose vështirësi teknike të tepërta për funksionimin dhe mirëmbajtjen";

- "kohëzgjatja e kontratave të tilla, si ajo e kontratave përsëritëse, si rregull i përgjithshëm, nuk kalon tre vjet".
- Furnizimet e kuotuar dhe të blera në tregun e mallrave
- **Blerja e furnizimeve me kushte shumë të favorshme:** Shmangia vlen për furnizimet që mund të blihen në kushte veçanërisht të favorshme nga:
  - një furnizues që është duke likuiduar biznesin e tij; ose
  - një likuiduesi në një procedurë falimentimi, një marrëveshje me kreditorët, ose një procedurë e ngjashme sipas ligjeve dhe rregullave kombëtare.

#### Përfshirjet për kontratat e shërbimeve publike:

- **Pas një konkursi të projektimit:** Shmangia zbatohet kur kontrata në fjalë duhet t'i jepet, në përputhje me rregullat e konkursit të projektimit, kandidatit/kandidatëve të suksesshëm. Shmangia lejohet me kusht që, kur janë dy ose më shumë kandidatë të suksesshëm, negocimi të ndërmerret me të gjithë kandidatët e suksesshëm.

#### Përfshirjet për kontratat e punëve publike dhe kontratat e shërbimeve publike:

- **Përsëritja e punëve ose shërbimeve:** Shmangia vlen për "vepra të reja ose shërbime të përbëra nga përsëritja e punimeve apo shërbimeve të ngjashme" që i besohen operatorit të njëjtë ekonomik në bazë të kontratës fillestare. Kjo lejohet "me kusht që këto punë ose shërbime të jenë në përputhje me një projekt bazë për të cilin është dhënë kontrata origjinale" në zbatim të një procedure në të cilën është publikuar një ftesë për konkurrim. Projekti themelor duhet të ketë treguar "shkallën e punëve ose shërbimeve të mundshme shtesë dhe kushtet në të cilat ata do të jepen".

#### Dispozita të veçanta për ndryshimin e kontratave gjatë mandatit të tyre

Direktiva sqaron se kur janë të mundshme modifikimet e një kontrate gjatë zbatimit së saj dhe tregon se si të vazhdohet me bërjen e këtyre ndryshimeve. Për më shumë informacion, shih Udhëzimin nr. 38 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Modifikimet kontratës*.

Duke marrë parasysh jurisprudencën përkatëse të GJED, rregulli i përgjithshëm mbetet i pandryshuar, domethënë që **në rast të ndryshimeve materiale të kontratës fillestare** (ose marrëveshjes kuadër) **është e nevojshme në procedurë e re e prokurimit**. Ndryshime të tilla demonstron qëllimin e palëve për të ri-negociuar kushtet thelbësore ose kushtet e kësaj kontrate. Kjo ndodh në veçanti nëse kushtet e ndryshuara do të kishin një ndikim në rezultatin e procedurës, po të kishin qenë pjesë e procedurës fillestare.

## Informacion i mëtejshëm

### **Botimet e SIGMA-s**

*Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik – Moduli C4*

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

Udhëzimi i Prokurimit Publik 38, *Modifikimet kontratës*